

Broshura për dekretin e pacientit

E nderuar paciente

I nderuar pacient

Në këtë broshurë njiheni me mënyrën se si veprojmë me dekretet e pacientëve dhe prokurat e përkujdesjes në Spitalin e Universitetit Zyrih.

Prokurë përkujdesjeje

Nëpërmjet prokurës së përkujdesjes mund të përcaktoni se kush do të marrë vendime në vendin tuaj dhe kush do t'ju përfaqësojë në çështje shëndetësore, financiare dhe juridike, nëse nuk keni më aftësinë për të gjykuar. Në çdo rast, autoriteti për mbrojtjen e të rriturve verifikon nëse ekziston një paaftësi për të gjykuar dhe vetëm pas kësaj prokura e përkujdesjes hyn në fuqi. Ashtu si testamenti, edhe prokura e përkujdesjes duhet të përpilohet me dorë ose duhet të noterizohet.

Dekreti i pacientit

Për aq sa jeni të aftë për të gjykuar, i merrni vetë të gjitha vendimet në lidhje me trajtimet mjekësore mbi bazën e rekomandimeve të mjekëve dhe mjekëve. Prokura e përkujdesjes vihet në përdorim vetëm nëse nuk jeni më të aftë për gjykim si pasojë e një aksidenti ose një sëmundjeje. Për situata të tilla, ju mund t'u përgjigjeni, ndër të tjera, pyetjeve të mëposhtme:

- Çfarë trajtimi mjekësor dëshironi?
- Cilat masa duhet të shmangen?
- Kush është **personi i autorizuar për përfaqësim** (Kodi Civil i Zvicrës, neni 378 ZGB - Kodi Civil i Zvicrës), cili **vendos** në vendin tuaj në lidhje me trajtimet mjekësore?

Përcaktimet që keni bërë paraprakisht vlejné vetëm në situatën kur nuk jeni më në gjendje të merrni vendime vetë. Në momentin që bëheni të aftë për të gjykuar, të gjitha vendimet terapeutike ekzistuese i diskutojmë sërisht me ju, pavarësisht nga çfarë keni përcaktuar në dekretin e pacientit. Nëse keni përpiluar një dekret pacienti, atëherë ua bëni më të lehtë të afërmeve dhe ekipit tonë të mjekëve që të marrin vendime të rëndësishme. Përcaktimet me shkrim mund t'i anuloni në çdo kohë dhe të ndryshoni dëshirat e trajtimit.

Askush nuk është i detyruar të ketë një dekret pacienti.

Vlefshmëria e dekretëve të pacientit

Çdo person i paaftë për të gjykuar mund të përpilojë një dekret pacienti, përfshirë edhe të rinjtë. Dekretet e pacientit janë juridikisht të vlefshme nëse ato janë përpiluar me vullnet të lirë, në një gjendje paaftësie për të gjykuar, lidhen me trajtimet mjekësore, dhe në të cilat është shkruar me dorë data dhe nënshkrimi.

Sjellja me dekretet e pacientëve në Spitalin e Universitetit Zyrih

Të gjithë specialistët tanë dëshirojnë të respektojnë dhe të zbatojnë vullnetin tuaj në çdo situatë. Prandaj është e rëndësishme që ekipi përgjegjës i trajtimit t'i njohë dëshirat dhe idetë tuaja. Prandaj, do t'ju luteshim që një **kopje të dekretit tuaj** t'ia dorëzoni mjekes ose mjekut tuaj të trajtimit. Këtë kopje ne e vendosim në dokumentacionin elektronik të pacientëve.

Gjatë qëndrimit në spital, ju këshillojmë të flisni me mjekun ose mjekun tuaj të trajtimit në lidhje me **përbajtjen e dekretit të pacientit**. Kësisoj, ju mund të siguroni së bashku se të dhënat e dekretit të pacientit pasqyrojnë vërtetë vullnetin tuaj aktual.

Në rast se nuk jeni të aftë për gjykim, mjeket dhe mjekët tanë, si dhe specialistët e përkujdesjes, janë të detyruar të respektojnë dekretin tuaj të pacientit. Ju do të trajtoheni ashtu siç e keni përcaktuar vetë, me përjashtim të rasteve kur një terapi duket jopremtuese nga ana mjekësore ose nëse përcaktimet bien ndesh me dispozitat ligjore. (Për shembull, nuk na lejohet që të përdorim medikamente me qëllimin për të shkurtuar jetën.)

Situatë emergjente me paaftësi të papritur për të gjykuar



Në situata emergjente është veçanërisht e rëndësishme të njihet vullneti juaj aktual, për të vepruar në përputhje me të. Nëse nuk keni përcaktuar një dekret ose nëse dëshirat tuaja nuk janë të njohura, në çdo rast marrim masa për mbajtjen në jetë. Nëse personeli ynë mjekësor merr dijeni, më vonë, për dekretin tuaj të pacientit, ne u përmbahemi dëshirave tuaja sa më shpejt të jetë e mundur dhe i përshtatim ato me terapitë që janë nisur më parë. Personi i autorizuar për t'ju përfaqësuar duhet të informohet gjithmonë në lidhje me ndryshimet e trajtimit; ai duhet të miratojë ose refuzojë në vendin tuaj masat mjekësore.

Përpilimi i dekretit të pacientit

Në mënyrë që dekreti i pacientit të jetë i zbatueshëm dhe që të pasqyrojë sa më mirë vullnetin tuaj, duhet të merrni parasysh pikat e mëposhtme:

Përmbajtje thelbësore

- Të dhëna në lidhje me identitetin (mbiemri, emri, datëlindja, adresa)
- Emërimi i një personi të autorizuar për përfaqësim me mbiemër, emër, adresë, dhe marrëdhënien familjare. Në mënyrë ideale, emërohet të paktën një person zëvendësues.
 - Nëse emëroni më shumë se një person të autorizuar për përfaqësim, duhet të përcaktoni një rend, ose të specifikoni shprehimisht që personat e emëruar duhet të vendosin bashkërisht.
- **Vërtetimi i aftësisë për të gjykuar**
 - Zgjidhni formulimin: "Në zotërim të aftësive të mia mendore dhe sipas pjekurisë për të vendosur deklaroj sa më poshtë ...".
 - Ju sugjerojmë që deklarata të nënshkruhet edhe nga një mjeke/mjet për të evituar pasiguri, nëse do të vihej në dyshim aftësia juaj për të gjykuar (p.sh. nëse ka shfaqet një sëmundje demence ose një vuajtje psikike).
- Përcaktime për trajtime mjekësore në përgjithësi dhe në veçanti për situatë emergjence
- Vendi, data dhe nënshkrimi

Përmbajtje me zgjedhje

- Nëse jeni i sëmurë, është me vend që këtë ta përmendni në dekretin e pacientit dhe parashikoni komplikime dhe masa të mundshme.
- Përshkruani vlerat tuaja personale dhe cilësinë e jetës.
- Përcaktoni bindjet, ankthet dhe pritshmëritë personale, të cilat janë rëndësishme për vendime mjekësore.
- Përcaktoni objektivat e trajtimit që dëshironi t'i arrini.
- Shkruani qartë dhe kuptueshëm se cilat masa mjekësore dëshironi dhe cilat i refuzoni.

Përmbajtje plotësuese

- Qëndrimi personal në lidhje me dhurimin e organeve.
- Dëshira në lidhje me trupin pas vdekjes (lejoni ose jo një autopsi mjeko-ligjore).
- Qëndrimin personal në lidhje me pjesëmarrjen në projekte kërkimore.

Sa më të qarta që formulohen përcaktimet tuaja në dekretin e pacientit, aq më e lartë është mundësia që të trajtoheni sipas dëshirës suaj.

Përditësimet e dekretive të pacientit

Është e rëndësishme që dekreti i pacientit të pasqyrojë gjithmonë vullnetin tuaj aktual. Për këtë qëllim, ju rekomandojmë ta kontrolloni gjithmonë dekretin tuaj të pacientit. Nëse rrethanat, qëndrimet dhe/ose situata juaj personale ka ndryshuar, duhet t'i mendoni sërish dekretet tuaja dhe, nëse është e nevojshme, t'i përshtatni. Ndryshimet tuaja duhet t'i shoqëroni gjithmonë me datën përkatëse dhe nënshkrimin tuaj.



Këshilla në lidhje me dekretet e pacientit

Lutemi, vini re se dekreti i pacientit, normalisht, nuk duhet të përpilohet nën presion kohe. Në mënyrë ideale, ju rekomandojmë që të mos e përpiloni vetëm dekretin e pacientit, por të merrni këshilla nga një specialist. Përveç kësaj, në Spitalin e Universitetit Zyrih është në dispozicion oferta e certifikuar e konsulencës "ACP" (Advance Care Planning).

- "ACP-ja" – "planifikimi i përbashkët paraprak i trajtimeve mjekësore" është koncept e zhvilluar ndërkombëtarisht në lidhje me planifikimin paraprak të kujdesit shëndetësor. Ju do të mbështeteni nga konsulente dhe konsulentë të trajnuar për të përpiluar një dekret pacienti, i cili pasqyron më së miri vullnetin tuaj dhe që është i zbatueshëm nga ana mjekësore.
- Në rast se, gjatë qëndrimit këtu te ne në Spitalin e Universitetit Zyrih, dëshironi të përpiloni një dekret pacienti, lutemi, drejtojuni mjekes/mjekut tuaj të trajtimit ose në zyrën e mëposhtme:

Shërbimi social

Sekretaria
sozialdienst@usz.ch
+41 44 255 22 11

